



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË LIBRAZHD

Nr. ____ prot

Librazhd 26/03/2025

**Raport mbi Veprimtarinë e Keshillit Bashkiak për Vitin 2024 dhe Transparencën në
Procesin e Vendimrresjes.**

Keshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarres i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmerisë, si dhe duke përdorur me efektivitet dhe efikasitet burimet njerezore, financiare, fizike e natyrore, duke punuar bazuar në parimet e interesit publik, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmerisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Vendimarrja e Keshillit

Keshilli i Bashkisë Librazhd, gjatë vitit 2024 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i perkasin shërbimit ndaj qytetarëve, zhvillimit të qytetit, mbështetjes dhe promovimit të sektoreve të ndryshëm të ekonomisë (bujqësisë, industrisë, shërbimeve, tregtisë, turizmit, etj) me ndihmë ekonomike dhe vendimet me karakter ekonomik që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e buxhetit për vitin 2024, projektet e propozuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet;
2. Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jonetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Librazhd si më poshtë:

Nr.	Muaji	Ndihme ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihme ekonomike për familje nga Fondi i kushtëzuar 6 %
1	Janar	1 familje	79 familje
2	Shkurt	4 familje	67 familje
3	Mars	-	51 familje
4	Prill	-	59 familje
5	Maj	2 familje	67 familje
6	Qershor	3 familje	73 familje
7	Korrik	1 familje	74 familje
8	Gusht	3 familje	74 familje
9	Shtator	2 familje	82 familje
10	Tetor	-	83 familje
11	Nëntor	-	86 familje
12	Dhjetor	-	88 familje



Te tjera vendime te miratuara:

- Dhenie me qera te tokave bujqesore, lista e sipërfaqeve kullosore dimerore dhe verore, me qellim miremenaxhimin e tyre dhe perdorimin e ketyre tokave ne dobi te fermereve dhe zhvillimit te bujqesise;
- Shtesa dhe ndryshime te buxhetit per vitin 2024 me qellim rritjen e efikasitetit te burimeve financiare dhe perdorimin e tyre ne sherbim te komunitetit, zhvillimit urban dhe rural, thithjes se investimeve dhe mbeshtetjes se ekzekutivit ne projektet e fituara nga qeveria qendrore, me fonde te Bashkimit European (BE), dhe donatore te trete te huaj;
- Buxhetin e vitit 2024 dhe projekt-buxhetin afatmesem te Bashkise Librazhd per vitet 2024-2026;
- Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne bashkine Librazhd per vitin 2024;
- Dhenien e titujve "Qytetar Nderi" bazuar ne kerkesat dhe trajtimin e dy komisioneve;
- Bursat per nxenesit e arsimit para-universitar dhe konviktet e shkollave te mesme profesionale, per vitinshkollor 2023-2024, si dhe mbeshtetjen e nxenesve ekselente.

Struktura e vendime te miratuara nga Keshilli viti 2024

- Nga totali **119** vendimete marra 119 vendime kane kerkuar konfirmimin e Prefektit te Qarkut nga te cilet 116 vendime jane konfirmuar dhe 3 jane kthyer per plotesim dokumentacioni.
- Vendimet me karakter normativ kane pasur te bejne me buxhetin dhe zbatimin e tij, permiresimin e sherbimeve, detajimin e shperdarjes se buxhetit etj;
- Dhenien e tokave me qera, mbeshtetjen e projekteve te fituara nga ekzekutivi, planet vendore per pastrimin, mbrojtjen nga zjarri, planet sociale te bashkise si dhe vendimet per mbeshtetjen e familjeve qe kane patur demtime te banesave te tyre nga zjarri;
- Vendimet te cilat jane me karakter personal, 15 prej tyre kane te bejne me dhenien e ndihmes ekonomike sipas muajve, vendime per procesin e privatizimit te banesave per lidhjen e kontratave para noterit, per banesat e para viteve 90, vendime per miratimin e listes se perfituesve te subvencionit te qirase dhe subvencionit te kredise, vendime per shtyrjen e afatit te kredise si dhe per vendosjen ne Shtepine e te Moshuarve si dhe titujt e nderit;
- Janë dhënë 4 tituj "Qytetar Nderi".

Keto vendime te Keshillit, tregojne bashkepunimin e Keshillit me administraten e Bashkise per t'ju pergjigjur ne kohe dhe sipas legjislacionit ne fuqi gjithe shqetesimeve dhe problematikave te komunitetit te qytetit te Librazhdit dhe njesive administrative.

Keshilli gjate kesaj periudhe ka qene aktiv, duke mbajtur mbledhje te radhes, mbledhje jashte radhe, sipas tabelës se me poshteme:



Muaji	Nr total i Mbledhjeve	Mbledhje te radhes	Mbledhje jashte radhe
Janar	1	1	-
Shkurt	1	1	-
Mars	1	1	-
Prill	1	1	-
Maj	1	1	-
Qershor	1	1	-
Korrik	1	1	-
Gusht	1	1	-
Shtator	1	1	-
Tetor	1	1	-
Nentor	1	1	-
Dhjetor	1	1	-

Gjate vitit 2024 nuk janë zhvilluar mbledhje online dhe mbledhje jashte rradhe.

Pjesemarrja e keshilltareve ka qene aktive si ne mbledhjet e komisioneve ashtu dhe ne procesin e vendimmanjes ne mbledhjet plenare online apo ato fizike. Komisionet e perhershmete Keshillit jane mbledhur per te diskutuar dhe miratuar projekt vendime te sjella nga administrata e Bashkise Librazhd qe kane te bejne sidomos me vendimet me karakter ekonomik dhe ne dhenien e pronave me qera, titujt e nderit, çeshtje juridike etj.

Ne vitin 2024 jane zhvilluar 3 mbledhje te Komisioneve.

Nr	Muaji	Mbledhje te Komisione te Perhershme
1	Janar	-
2	Shkurt	-
3	Mars	-
4	Prill	1
5	Maj	-
6	Qershor	-
7	Korrik	-
8	Gusht	-
9	Shtator	-
10	Tetor	-
11	Nentor	1
12	Dhjetor	1
Total		3



Duke u nisur nga karakteri i vendimeve, ato ndahen në vendime për qeshitje:

1. Financiare;
2. Sociale
3. Infrastruktura dhe strehimin
4. Problemet urbane dhe asetet
5. Emergjencat civile;
6. Qeshitje të arsimit dhe kulturës;
7. Tajtim dhe mbetje;
8. Planet lokale

Transparenca e Keshillit.

Në zbatim të rregullores të miratuar është vendosur në funksionim regjistri fizik i ankesave/kerkesave dhe një regjister fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kerkesat e mberitura në drejtim të Keshillit të Bashkisë, regjistri elektronik i mbledhjeve të Keshillit me të gjitha kolonat që sigurojnë informacion të plotë për zhvillimin e mbledhjeve, dhe regjistri elektronik i projektakteve (në faqen e internetit të bashkisë, rubrika Keshilli).

Gjatë vitit 2024 u depozituan në total 24 kërkesa drejtuar Keshillit Bashkiak. Kërkesat janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Është pasuruar faqja e internetit të Bashkisë, Rubrika e Keshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kategorive të mëposhtme:

- Vendimet e Kryesise se Keshillit Bashkiak;
- Vendimet e Keshillit Bashkiak;
- Projektvendimet;
- Procesverbalet;
- Konsultimet publike;
- Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare;
- Regjistri elektronik i mbledhjeve;
- Regjistri elektronik i projektakteve;
- Njoftimet dhe renditjet;
- Aktivitete të Keshillit, etj

Gjithçka me lart bëhet transparente, dhe qytetarët mund t'igjejnë në faqen e internetit të Bashkisë, rubrika Keshilli të gjitha informacionet dhe dokumentat përkatëse.

Për të thelluar më shumë transparencën, Keshilli i paisur dhe mbështetur nga Projekti Bashki të Forti me pajisje IT të plota (donacion-Ekran, Kamera, Mikrofon, Laptop, dhe kablo), ka regjistruar dhe transmetuar direkt (live) në facebook të Keshillit, të gjitha mbledhjet e Keshillit gjatë vitit 2024.



Roli perfaqesues i Keshillit

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014, "Per konsultimin Publik", ne zbatim te planit te aktiviteve/punes dhe pergatitjes se Tavanave Buxhetore te Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2025-2027, paketes Fiskale 2025, dokumentin final te PBA 2025-2027 dhe Buxhetit 2025, Keshilli ne bashkepunim me ekzekutivin kane marrepjesene 7 degjese publike te gjitha njesite administrative te bashkise me grupe te ndryshme interesi, perfshire "keshillin rinor", grate grupet vulnerable, etj, qe kane te bejne me hartimin e Paketes Fiskale per vitin 2025, me zbatimin e buxhetit per vitin 2024 dhe kerkesat buxhetore per vitin 2025, persa i perket miratimit te sistemit te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2025, te buxhetit te Bashkise Librazhd per vitin 2025 si dhe projekt-buxhetit afatmesem te Bashkise Librazhd per vitet 2025-2027.

Aktivitetet e mesiperme u publikuan ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Duke konsideruar rendesine e pjesemarrjes se grupeve vulnerable ne procesin e vendimmarrjes, Keshilli ne zbatim te planit te aktiviteve/punes se tij, me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, zhvilloi ne 6 nentor 2024 nje konsultim/degjese te vecante me komunitetin Egjiptian per marrjen e nevojave dhe prioriteteteve te ketij komuniteti dhe konsiderimin e prioriteteteve te tyre ne buxhetin e vitit 2025 dhe ne PBA 2025-2027. Aktiviteti u publikua ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Keshilli ka marre pjese ne seanca degjimore sebashku me administraten e Bashkise ku jane mbajtur shenim kerkesat, sugjerimet dhe opinionet e pjesemarrjesve, i jane percjelle Komisionit te Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, dhe jane reflektuar/konsideruar ne dokumentat perkatese.

Te gjitha degjesat/konsultimet publike te siperpermendura jane publikuar ne faqen e internetit te Bashkise, Rubrika Keshilli Bashkiak, Aktivitete te Keshillit, dhe ne facebook te Keshillit.

Gjate mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, keshillaret kane shprehur kerkesa dhe ankesat e qytetareve te zonave qe perfaqesojne te cilat i jane parashtruar ekzekutivit dhe jane diskutuar me tej per te marre zgjidhje rast pas rasti.

Per vitin 2024 buxheti i Keshillit Bashkiak eshte realizuar pothuajse i plote.

Forcimi i kapaciteteve te Keshillit (Komisionet dhe Udheheqja e Keshillit)

Me mbeshtetjen e Projektit Bashki te Forta, Komisionet e Keshillit Bashkiak – Komisioni i Veprimtarise Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Prones dhe Zenies me Pune (dy anetare te komisionit), Komisioni i Barazise Gjinore (dy anetare te Komisionit), Komisioni i Arsimit, Kultures, Sporteve, Shendetesise dhe Ceshtjeve Sociale (dy anetare te Komisionit) dhe Komisioni te Sherbimeve Publike (dy anetare te Komisionit) u trajnuan intensivisht mbi:



Roli i komisioneve në monitorimin e ekzekutimit,

- Strukturat drejtuese të Këshillit,
- Komisionet e përbërësit të këshillit të bashkisë,
- Objekti i punës së komisioneve,
- Funksionimi i komisioneve;
 - Roli i komisioneve në vendimmarrje, organizimi dhe zhvillimi i mbledhjeve të komisioneve, përgatitja e raporteve të vendimmarrjes së komisioneve për projekt dhe procesverbaleve përkatëse;
 - Roli i komisioneve në konsultimin publik të këshillit planifikimi, organizimi dhe zhvillimi i konsultimeve publike sipas planit të konsultimeve të këshillit.

Trajnime të zhvilluar në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Qarkut Elbasan. Për dy komisionet e para trajnimi u zhvillua në datë 19 prill 2024, dhe për dy komisionet e tjera në datë 16 maj 2024.

Gjithashtu, me mbështetjen e Projektit Bashki të Forta, Kryesia e Këshillit – Kryetari dhe dy NënKryetarët e këshillit u trajnuan në temat si më poshtë:

- Vetëqeverisja vendore, rolet dhe funksionimi i Këshillit Bashkiak,
- Roli i këshillit bashkiak në mbikqerjen e sistemit të kontrolit të brendshëm të bashkisë,
- Drejtuesit e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik, planifikimi dhe buxheti i këshillit.

Trajnimi u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Librazhd, në datë 17 tetor 2024. Pjesëmarrës aktiv në trajnim ishte edhe Sekretari i Këshillit.

Barazia gjinore dhe Aleanca e Grave Këshilltare

Komisioni i Barazisë Gjinore në bashkëpunim me Aleancën e Grave Këshilltare (AGK) të Bashkisë librazhd kanë adresuar rregullisht çështje të ndryshme që sipas barazisë gjinore në veprimtarinë e Bashkisë Librazhd dhe në bashkëpunimin shpirtëror e nismat - mbledhjet e grave që bëjnë punë artizanale/gatime tradicionale. Nisma veshesh dhe mbledhjet e bashkisë të Bashkisë, viti 2025.

Mbajtja e dokumentacionit

Me mbështetjen e Projektit Bashki të Forta, sekretariati i Këshillit është pajisur me dosje dhe mbajtja e dokumentacionit është si më poshtë:

- Dosja e Protokollit të Brendshëm (Ndërveprimi me Administratën)
- Dosja e korespondencës me Prefektin.
- Dosja për Projekt-Vendimet
- Dosja për Vendimet e Këshillit
- Dosja e Vendimeve dhe Proces Verbalet e mbledhjeve të Kryesise
- Dosjet e Proces Verbaleve të Mbledhjeve të Këshillit (Minutes)
- Dosjet e Proces Verbaleve të Votimit.



- Dosjet e Komisioneve
- Dosjet per Proceset e konsultimeve dhe Regjistri i Konsultimeve
- Dosjet e Grupeve Politike (nderveprimit te Keshillit me to)
- Dosjet me kerkesat e Keshilltareve per Informim me dok zyrtar
- Dosje per ankesat kerkesat dhe Regjistri Perkates
- Dosje per Nismat dhe Regjistri
- Dosje per Planet e punes se keshillit si dhe Buxhetin perkates (nderveprimi me administraten per shoenzimet)
- Dosjet per titujt e nderit dhe komisione te ndryshme qytetare

Vazhdimesia dhe e Ardhmja

Mbetet si detyre mjaft e rendesishme per te ardhmen gjetja e menyrave dhe formave te tjera per te komunikuar me publikun per çeshtje si: diskutimi per buxhetin e bashkise, paketes fiskale, tjetersimit dhe dhenies me qera te pronave, zbatimi i standardeve e rregulloreve etj. Me qellim pjesemarrjen aktive ne vendimarrjet e komunitetit, ku çdo keshilltar per aktet normative, te cilat do te diskutohet dhe vendoset ne Keshill, te marre opinionet dhe verejtjet publike ne lagjen ose fshatin qe ata perfaqesojne me qellime vendim-marrja te jete ne sherbimte komunitetit.

Gjithashtu, mbledhjet e komisioneve duhet te zhvillohen rregullisht, te mbahen procesverbalet dhe pergatiten raportet e vendimarrjes per cdo projekt akt te shqyrtuar dhe prezantuar ne mbledhjet plenare te Keshillit.

Persa me siper ju falenderojme secilin per kontributin e dhe ne dhe ju ftojme te jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja per permiresimine punes se Keshillit.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elson MALLUTA

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mitat BICAKU